



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PORTI DETAR SHA SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. 570/1 .Prot.

Sarandë, më 19.11.2025

PROCESVERBAL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti: “Blerje automjeti për administratën”.

Procedura: “E hapur e thjeshtuar”- Mall, (elektronikë).

Fondi limit: : 3.500.000 (tre milion e pesëqind mijë) Lek,pa TVSH

Burimi: Vetëfinancim

Afati: 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Referenca: Programi ekonomik i Shoqërisë për vitin 2025.

CPV: Automjete 34100000-8.

Udhëzimi I APP (Manuali) Nr.1 datë 03.06.2025 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”

PROCEDURË E RISHPALLUR

Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit REF-64349-10-10-2025

Arsyet e Anulimit:

konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

KODI OUTPUT: 0000000

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM- së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **PORTI DETAR SHA SARANDË** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

c. Formularin e Ofertës Ekonomike, sipas Shtojcës 1;

d. Listat e Çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi:

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 - Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, sipas Shtojcës 9.

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës.

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: **70 000 lekë (shtatëdhjetë mijë) Lek.**

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Formularin e ofertes sipas Shtojcës 1 dhe Listat e Çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 3:



Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, çdo operator ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të ofertës së tij edhe formularin e ofertës sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 3 të Dokumenteve Standarte të Tenderit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Të jetë i specifikuar në QKB objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik i njëjtë ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit).

2.1.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Liçensë për ushtrimin e aktivitetit të lëshuar nga QKB: Kategoria: “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”. Nënkatëoria: VII.3.B – *Blerja, shitja e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio*.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-ës, I ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa që OE duhet të jetë i pajisur me Liçensë për ushtrimin e aktivitetit të lëshuar nga QKB: Kategoria: “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”, Nënkatëoria: “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura”, Kodi: VII.3.B, është vendosur në zbatim të Ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, VKM Nr. 107, datë 10.02.2016, “Për një shtesë në VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Udhezimit nr. 1545, dt. 29.03.2016, “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe /ose rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën në njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qenë se lloji i procedurës është “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, gërma “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:..... b) 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.....”;

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit



publik” ku përcaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin (sipas QKB-së).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Duke qenë se autoriteti kontraktor është njësi e autoriteteve vendore e gjen të arsyeshme që pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë ofertues në këtë procedurë prokurimi ta kushtëzojë me shlyerjen në kohë të taksave vendore të parashikuara me ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë



19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (furnizimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për furnizime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqes ISO 9001-2015.

Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas ISO/IEC 9001 2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente. Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën Certifikatë ISO 9001:2015 (ose ekuivalente). Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar dhe të provohet garantimi i standardeve të kërkuara në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht mallra cilësore që plotësojnë kërkesat të AK-së dhe është i përkushtuar për përmirësimin e vazhdueshëm.

2.3.3 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik për mjetin e ofruar duhet të paraqesë në SPE një katalog ose skedë teknike ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjetit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Në katalogun ose skedën teknike duhet të jetë specifikuar mjeti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, ku të gjëjmë pasqyrim për parametrat teknikë të produktit (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar, përveç elementëve teknik specifik, termave në anglisht që përdoren ndërkombëtarisht, që janë vendosur në specifikimet teknike me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6-b, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e



specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetin e ofruara nga operatori ekonomik.

2.3.4 Operatori ekonomike duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjetit pranë Autoritetit Kontraktor brenda afatit të përcaktuar (30 ditë nga lidhja e kontratës) dhe në momentin e dorëzimit të mjetit do ta shoqërojë atë me të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë:

Çertifikatën e pronësisë së mjetit (në emër të AK)

Lejen e qarkullimit të mjetit (në emër të AK)

Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (në emër të AK)

Certifikatën e kolaudimit (inspektimit) (në emër të AK)

Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike (në emër të AK)

Shpenzimet për kalimin në pronësi të autoritetit kontraktor do të mbulohen nga operatori ekonomik që do të shpallet fitues.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjeti do të dorëzohet pranë AK brenda afatit të përcaktuar, i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së

2.3.5 Kategoria mjedisore e mjetit objekt prokurimi, duhet të përmbush kriteret për EURO 6. Për përmbushjen e këtij kushti OE duhet të paraqesë në SPE, vërtetimin lëshuar nga DRSHTRR përkatëse, për kategorinë mjedisore të mjetit EURO 6.

Argumentimi: Standardi EURO 6 është klasifikimi më i fundit i standardeve europiane që siguron ndotje minimale të ajrit. Norma e emisionit të CO₂ ≤130 gr/km, është zgjedhur në respekt të mbrojtjes së mjedisit si dhe në angazhim ndaj teknologjive të pastra.

2.3.6 Deklaratë garancie për mjetin e ofruar, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 1 vit.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

VO: Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e kontrollit teknik të mjetit në servis të autorizuar si dhe kontrollin e kilometrave të përshkruar të mjetit.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose*



palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, **sjellim në vëmendje se:**

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t’i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do të jetë kusht s’kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP-së, si dhe të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas shkresës Nr.2065 Prot, date 12.04.2022.

Në specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Specifikimet Teknike në DST hedhur në SPE www.app.gov.al- Shtojca 6.

Karakteristika të përgjithshme dhe përmasat: MAKINE SUV

Viti I prodhimit pas 1 Janar 2022

Kilometrat e përshkuara Max 50 000 km

Lartësia e mjetit 1685 mm-1710mm

Gjerësia e mjeti 1900 mm-1950 mm

Gjatësia e mjetit 4750 mm---4800 mm

Numri I akseve 2

Distancë aksiale 2755mm-2770mm

Ulëse (sedile), 6+1

Kategoria ambientale EURO 6

Dimensionet e gomave 20”



Sistem i lëvizje 4x4
Lënda djegese naftë
Fuqia 140-150kë
Numri i cilindrave 4
Volumi i motorrit 2050-2200cc
Transmisioni: automatik

Mjeti duhet te jete i pajisur:

Opsione

Ngjyra e zezë
Ulesët me sistem ngrohje-ftohje, me lëkurë
Sistemi ndricimit fener LED inteligjent
Kroskoti digital
Kamer parkimi
Display elektronik
Afati lëvrimit 30 dite ng lidhja e kontratës.
Sinjalizues parakalimi ne pasqyre 1

Specifikimet janë hartuar nga Ekspert fushe i kontraktuar nga AK për këtë objekt prokurimi, në përputhje me nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për hartimin e specifikimeve teknike të automjetit eksperti është mbështetur dhe ka patur si reference natyrën e punës dhe aktivitetin për të cilin kërkohet të blihet ky autojmet. Qëllimi i blerjes së këtij automjeti është që ai do të jetë në shërbim të administratës për plotësimin e nevojave të lëvizjeve në zbatimin e detyrave funksionale të sektorëve të ndryshëm. Gjithashtu janë përcaktuar kufij dhe parametra minimalë për sa iu përket përmasave të automjetit. Në këtë mënyrë specifikimet teknike janë gjithë përfshirëse dhe në përputhje të plotë me kërkesat e institucionit në raport me aktivitetin funksional që ky automjet do të kryejë.

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të DST-ve të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Fondi limit është përcaktuar nga komisioni i përgatitjes së programit ekonomik për vitin 2025, nr.667.prot, dt.17.12.2024.2024.

Autoriteti Kontraktor, Porti Detar ShA Sarandë, ka miratuar preventivin për fondin limit dhe specifikimet Teknike, dhe është në fazën e prokurimit të projektit.

Si rrjedhojë, kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”i nryshuar, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të



tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e realizuar, pasi specifikimet janë hartuar dhe miratuar paraprakisht.

Në përfundim të miratimit të specifikimeve teknike, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **02.12.2025, ora 12:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik në faqen e APP-së si dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **“Blerje automjeti për administratën”**, Njësia e Prokurimit përcaktoi anëtarin e njësive të prokurimit R.A.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali:

- Dokumentat standarte të tenderit
- Specifikime Teknike
- Njoftimi i Shkurtuar i Kontratës

NJËSIA E PROKURIMIT